



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE

Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Nr./Br.

31121

Datë/Datum.

01.03.21

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PRISHTINË - PRISTINA  
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 31/21

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Goran Milenković- Kryetar, z. Nuhi Paçarizi- Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OEN.N.P “Vetoni” & N.T.P “Adrizaun- Rrethoja”- Rahovec, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Renovimi – Rrethimi i terreneve sportive – Kontratë dy vjeçare” me numër të prokurimit: “632-20-7526-5-2-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ “KK Gjakovë”, më datën: 25.02.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**I. APROVOHET**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: N.N.P “Vetoni” & N.T.P “Adrizaun- Rrethoja”- Rahovec, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Renovimi – Rrethimi i terreneve sportive – Kontratë dy vjeçare” me numër të prokurimit: “632-20-7526-5-2-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ “KK Gjakovë”.

**II. ANULOHET**, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Renovimi – Rrethimi i terreneve sportive – Kontratë dy vjeçare” me numër të prokurimit: “632-20-7526-5-2-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ “KK Gjakovë” dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues N.N.P “Vetoni”& N.T.P “Adrizaun- Rrethoja”- Rahovec, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE N.N.P “Vetoni” & N.T.P “Adrizaun- Rrethoja”- Rahovec, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 11.01.2021 me nr. 31/21, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Renovimi – Rrethimi i terreneve sportive – Kontratë dy vjeçare” me numër të prokurimit: “632-20-7526-5-2-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ “KK Gjakovë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 7, 59, 62, 64, 67, dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, nenin 44.5 të RRUOPP-së

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 13.01.2021, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 19.01.2021, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues / Komuna Gjakove, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës është pune me vlerë të mesme. Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, përkatësisht kundër arsyetimit të eliminimit të parashtruesit të ankesës ku AK, përmes letrës standarde tekstualisht ka potencuar: “Ju si OE nuk keni prezantuar mjeshër për saldim dhe një kamion kiper me tonazh 3.5t”.

Përgjigjeje në pretendimin ankimore (neni 113):

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lendes kundrejt pretendimeve ankimore sqarojmë se parashtruesi i ankesës së bashku me oferte ka prezantuar kopjen e certifikatës, të lëshuar nga Agjencia

e Punësimit e Republikës së Kosovës - Qendra për aftësim profesional në emër të z. Ardian Thaçi – SALDUES. Po ashtu është prezantuar edhe kopja e librezës së Kamionit Kiper, me CRA nr. 1050890, dhe nr. targash 07-162-DL. AK – Komuna nuk e ka konkretizuar apo qartësuar arsyetimin e eliminimit të kartë. Nëse i është referuar, aciditetit të qarkullimit rrugor siç pretendon parashtruesi i ankese, në vlerësojmë se qarkullimi rrugor i automjeteve bie në juridiksion të ligjeve tjera jo dispozitive të LPP-se, rrjedhimisht nuk mund të eliminohet një operator ekonomik i caktuar me arsyetimin se pajisje nuk është e regjistruar për qarkullim rrugor. Si prove bashkëgjatur me oferte gjëni kopjen e certifikatës së Salduesit dhe kamionit kiper të prezantuar në oferte.

Përfundimisht propozimi ynë për AK – Komuna Gjakovë është që lenden ta kthejë në ri vlerësim me qëllim që të pasqyrohet gjendja reale e ofertës kundrejt kërkesave bazuar në dispozitat ligjore për prokurim publik në fuqi.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues NNP “Vetoni & NTP Adrizaun- Rrethoja”- Rahovec të aprovohet si e bazuar, të anulohet propozimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në Ri vlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 19.01.2021, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në: OE nuk ka prezantuar këtë certifikatë së bashku me oferte mirëpo e ka prezantuar së bashku me Kërkesën për rishqyrtim që i bie që është ndryshim dokumenti meqenëse nuk ka pjesë e dokumentacionit të ofertës dhe sipas RRUOPP “39.2 Asnjë ndryshim në çmim ose kusht tjetër material ose aspekt të tenderit nuk mund të kërkojë, ofrohet ose lejohet. Sa i përket kamionit të kërkuar, AK sqaron se në dosje të tenderit është kërkuar “1 Kamion kiper me tonazh të vogël deri 3.5t (kamioni duhet të ketë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit)” ndërsa OE ka ofruar kamion me targa 07-162-DL e që nuk e ka peshën e kërkuar siç është kërkuar në dosje të tenderit. Për më shumë shih pamjen më poshtë:

CRA/YPB/VRC 1050890

A	Shprehja e peshës së reaktantit	07-162-DL
B	Shprehja e peshës së reaktantit	01-10-2019
C	Shprehja e peshës së reaktantit	
C.2	Shprehja e peshës së reaktantit	
C.2.1	Shprehja e peshës së reaktantit	
C.2.2	Shprehja e peshës së reaktantit	
C.2.3	Shprehja e peshës së reaktantit	
D	Shprehja e peshës së reaktantit	16-05-2000
D.1	Shprehja e peshës së reaktantit	MECO
D.2	Shprehja e peshës së reaktantit	MLBOE


CRA/YPB/VRC 1050890

D3	Shprehja e peshës së reaktantit	2000
E	Shprehja e peshës së reaktantit	
S	Shprehja e peshës së reaktantit	
D	Shprehja e peshës së reaktantit	
S.1	Shprehja e peshës së reaktantit	
S.2	Shprehja e peshës së reaktantit	
Q	Shprehja e peshës së reaktantit	
P	Shprehja e peshës së reaktantit	5000
P.1	Shprehja e peshës së reaktantit	1320
G	Shprehja e peshës së reaktantit	4450
K	Shprehja e peshës së reaktantit	

07-162-DL

CRA/YPB/VRC 1050890

P	Shprehja e peshës së reaktantit	100
P.1	Shprehja e peshës së reaktantit	5001
P.2	Shprehja e peshës së reaktantit	Ditël
P.3	Shprehja e peshës së reaktantit	
K	Shprehja e peshës së reaktantit	E Kugo
W	Shprehja e peshës së reaktantit	Kamion Kiper 2 Dyrë



Operatori Ekonomik, nuk ka kthyer përgjigje.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 11.02.2021, përmes platformës zoom e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtrirat e palëve në procedurë.

Kryetari i panelit hapi seancën e shqyrtimit kryesorë të ankesës të mbajtur në ZOMM në ora 11:00 ku morën pjesë të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesit e OE-së ankues, përfaqësuesit AK-së nuk ka qenë prezent në seancë, eksperti shqyrtues,

Kryetari i panelit i njoftoi të pranishmit me përbërjen e panelit, dhe pasi konstatoi se nga të pranishmit nuk pati vërejtje në këtë përbërje, vazhdoi me seancën.

Kryetari i panelit i njoftoi të pranishmit me objektin e shqyrtimit si dhe me shkresat e lëndës dhe në vazhdim fjalën ia dha përfaqësuesit të OE-së ankues i cili deklaroi : ne me kërkesën për rishqyrtim edhe me ankesë se pari sa i përket mjeshtrit për saldimit ne me ofertë i kemi dorëzuar edhe dëshmitë se zotëri Ardian Thaçi është i certifikuar si punëtor dhe e ka dokumentin adekuat për saldimit mirëpo AK në vendimin për refuzimin e kërkesës tone për rishqyrtim i është referuar një emri tjetër dmth për Arton Thaçin po Arton Thaçi nuk është i caktuar si mjeshtr për saldimit ne këtë aktivitet të prokurimit por është Ardian Thaçi prandaj dëshmia në lidhje me certifikimin atij është e bashkangjitur në dosje të tenderit dhe njëkohësisht është valide kjo dëshmi ndërsa sa i përket arsyeja tjetër për eliminimin në lidhje me kamionin kiper ju sqarojmë se ne me rastin e ngarkimit të dokumentacionit pra me rastin e ofertimit ne kemi bashkangjitur librezën e këtij kamioni me afat të skaduar gabimisht se e kemi pas kamionin e regjistruar dhe ka pas validitet , si dëshmi që kamioni është i regjistruar ne i kemi bashkangjitur librezën e kamionit në kërkesën për rishqyrtim mirëpo edhe në ankesë e të cilën ne mund tua prezantojmë edhe tani , ju e kemi në dokumentacion ku shihet shumë qartë që ky kamion është i regjistruar para datës së fundit të dorëzimit të ofertave pra kamioni është i regjistruar me datën 26.09.2020 dhe ka vlefshmëri deri me datën 30.09.2021 mirëpo AK nuk e ka shfrytëzuar të drejtën ligjore dhe mundësin ligjore konform nenit 59.2 dhe dispozitave të nenit 72 të LPP-së të kërkojë sqarime në lidhje me këto dëshmi. Këto janë në pika të shkurtra sqarimet tona në lidhje me eliminimin edhe njëherë e konfirmojmë se pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues që ky aktivitet i prokurimit të kthehet në rivlerësim

Ne fjalën përfundimtare Eksperti deklaroj : u kuptua qe ankesa ka te beje me arsyen e eliminimit unë kom propozua qe lënda mu kthye ne rivlerësim , rivlerësimin e kom arsyetua përmes provave do te thotë behet fjalë për certifikatën e salduesit ku OE ankues e ka prezantua ne ofertë edhe atë ne emër te Ardian Thaqit arsyeja tjetër ka te beje me kamioneten ku e kanë kërkuar këta me betonazh deri ne 3.5 tone edhe ketë dëshmi edhe ketë dëshmi unë e kom prezanto si provë ky zotëria ankuesi pra ka prezantua peshën maksimale te ngarkesës 1320 kg pra un kam propozua qe lënda mu kthye ne rivlerësim.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron:

Paneli shqyrtues Sqaron se: Autoriteti Kontraktues / Komuna Gjakove, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës është pune me vlerë të mesme. Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për anulim te aktivitetit te prokurimit, përkatësisht kundër arsyetimit te eliminimit te parashtruesit te ankesës ku AK, përmes letrës standarde tekstualisht ka potencuar: “Ju si OE nuk keni prezantuar mjeshtër për saldim dhe një kamion kiper me tonazh 3.5t”.

Paneli Shqyrtues Konform ekspertit shqyrtues sqaron se: Pas administrimit dhe shqyrtimit te shkresave te lendes kundrejt pretendimeve ankimore sqarojmë se parashtruesi i ankesës se bashku me oferte ka prezantuar kopjen e certifikatës, te lëshuar nga Agjencia e Punësimit e Republikës se Kosovës - Qendra për aftësim profesional ne emër te z. Ardian Thaçi – SALDUES. Po ashtu është prezantuar edhe kopja e librezës se Kamionit Kiper, me CRA nr. 1050890, dhe nr. targash 07-162-DL. AK – Komuna nuk e ka konkretizuar apo qartësuar arsyetimin e eliminimit kartë. Nëse i është referuar, aciditetit te qarkullimit rrugor siç pretendon parashtruesi i ankese, ne vlerësojmë se qarkullimi rrugor i automjeteve bie ne juridiksion te ligjeve tjera jo dispozitave te LPP-se, rrjedhimisht nuk mund te eliminohet një operator ekonomik i caktuar me arsyetimin se pajisje nuk është e regjistruar për qarkullim rrugor. Si prove bashkangjitur me oferte gjeni kopjen e certifikatës se Salduesit dhe kamionit kiper te prezantuar ne oferte.

Paneli Shqyrtues Konform ekspertit shqyrtues sqaron se: Përfundimisht Vendimi ynë për AK – Komuna Gjakove është qe lenden ta kthej ne ri vlerësim me qellim qe te pasqyrohet gjendja reale e ofertës kundrejt kërkesave bazuar ne dispozitat ligjore të LPP-së.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk ka bërë vlerësimin dhe ekzaminimin e tenderëve në harmoni me kërkesat e FDT-së, duke mos vepruar në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Andaj obligohet AK që gjatë rivlerësimit, ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së .

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK-“Kuvendit Komunal Gjakovë”

1x1 OE- N.N.P “Vetoni” & N.T.P “Adrizaun- Rrethoja”- Rahovec

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.